

V E N D I M
Nr.526, datë 14.11.1999

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË, PËR VENDOSJEN E LINJËS NDËRKOMBËTARE LIQENORE PËR PASAGJERË POGRADEC-OHËR

Në mbështetje të neneve 81 dhe 121 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998, "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme,

KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D O S I :

Miratimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Maqedonisë, për vendosjen e linjës ndërkombëtare liqenore për pasagjerë Pogradec-Ohër.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta